



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 11
Prishtinë, më 28.5.2013, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N – 10.

PROCESVERBAL
I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali, kryetare, Biserka Kostiq, Rita Hajzeraj - Beqaj, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyçi, Kymete Bajraktari, Justina Pula dhe Duda Balje.

Pjesëmarrës të tjerë: Visar Bivolaku-EUO/EUSK; Lejla Selimi-OSBE; Ervin Ibrahim-UNDP; Florije Kryeziu- UNICEF dhe Arben Kelmendi-UNDP.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 16 dhe 24 prill 2013;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për monitorimin e Ligjit për barazi gjinore;
4. Shqyrtimi i peticioneve dhe kërkesave;
5. Të ndryshme.

Kryetarja – Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 16 dhe 24 prill 2013

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 16 dhe 24 prill 2013.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për monitorimin e Ligjit për barazi gjinore

Kryetarja – Prezantoi para komisionit punën e grupit punues për monitorimin e Ligjit për barazi gjinore. Ajo tha se është bërë një punë shumë e mirë dhe keni marrë raportin me kohë. Ne si grup punues, kemi bërë vizita dhe kemi përdorur metodën e pyetësorëve në institucione dhe ndërmarrje publike, si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë qendror. Sa i përket zbatimit të Ligjit për barazi gjinore, mund të themi se niveli qendror është më mirë sesa niveli lokal, por nuk ka zbatim njëqind për qind të ligjit. Ajo më pas bëri prezantimin e rekomandimeve, të cilat kanë dalë si rezultat i të gjeturave gjatë monitorimit të ligjit, por tha se duhet të shtohet edhe një rekomandim, që ka të bëjë me pronën dhe trashëgiminë.

Kurtan Kajtazi – Tha se për monitorimin e këtij ligji është punuar shumë, por më intereson se si është puna e respektimit të barazisë gjinore në institucione shkollore, në institucione shëndetësore dhe në komuna, dhe sa është numri i femrave që marrin paga nga buxheti i Kosovës.

Kryetarja – Tha se kemi shpërndarë pyetësorë në të gjitha komunat dhe ministritë. Përqindja është nxjerrë në bazë të asaj se si kanë raportuar, ndërsa këto të dhëna i kemi të prezantuara me tabela, por do të shpërndajmë pyetësorët edhe në nivelin lokal për këto institucione se si është situata e pozitës së femrës në pozitat vendimmarrëse.

Kymete Bajraktari – Tha se duhet gjetur rrugën më të lehtë për të marrë këto statistika, duke dërguar pyetësorët nëpër ministri për nivelin lokal, sepse ministritë i kanë të dhënat për nivelin lokal.

Biserka Kostiq – Tha se ajo e ka marrë një raport të pakompletuar, për shkak të përkthimit dhe nuk është në dijeni se a mungon pyetësori për komunat serbe apo nuk është dërguar fare, dhe nëse janë dërguar, a janë përgjigjur.

Kryetarja – Tha se edhe në komunat serbe është dërguar pyetësori, por nuk ka përgjigje.

Kimete Bytyçi – Tha se edhe në pozita udhëheqëse për drejtorë ka mundësi të zgjedhën femrat gjatë konkurrimit, edhe nëse është zgjedhje politike.

Kryetarja – Tha se Komisioni Evropian është shumë i interesuar për raportin e monitorimit të këtij ligji. Ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm për këtë raport. Gjithashtu, ne mund të bëjmë hulumtime, mirëpo nuk qëndrojmë mirë sa i përket pozitës së femrës në vendimmarrje, prandaj nuk po e miratojmë sot këtë raport. Pra, ne duhet t'i

kërkojmë edhe këto të dhëna nga këto dy ministri dhe pasi t'i marrim përgjigjet, e plotësojmë raportin dhe e miratojmë.

Rita Hajzeraj – Tha se femra të punësuar ka, por në pozita udhëheqëse ka shumë pak. Këtu i kemi të dhënat e paraqitura në tabela për ministrinë dhe për nivelin lokal, por nëse duam t'i zbërthejmë në detaje, unë jam që të bëhet për të gjitha ministrinë.

Kryetarja – Tha se është për një raport sa më të kompletuar dhe për këtë po kërkojmë nga Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme informata shtesë për numrin e të punësuarve dhe pozitave vendimmarrëse nëpër komuna në dikasteret e këtyre ministrive.

Për këtë propozim votuan të gjithë anëtarët e komisionit, përveç Albana Gashit, e cila abstenoj.

4. Shqyrtimi i peticioneve dhe kërkesave

Kurtan Kajtazi – Tha se kemi një petition nga popullata e Komunës së Dragashit për heqje dorë nga sipërfaqja jashtëzakonisht e madhe prej 57% nga territori i komunës dhe detajimi i kufijve të rinj të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Ai tha se ky petition nuk bie në kompetencë të Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe se këtë petition duhet proceduar për shqyrtim në Komisionin për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, si komision kompetent.

Albana Gashi – Në këtë petition ceket se këta qytetarë kanë bërë disa ankesa dhe rekomandime në Komisionin për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, por nuk u janë marrë parasysh. Unë mendoj se ligji nuk është kuptuar mirë. Këtu ceket se nuk kemi të drejtë për të shfrytëzuar pyllin. Këta e kanë të drejtën e shfrytëzimit, por në mënyrë racionale. Ne mund t'i rekomandojmë Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, që të na sqarojë lidhur me këtë situatë, pasi që ata si komision, për këtë çështje kanë mbajtur dëgjim publik.

Kurtan Kajtazi – Tha se si komision, mund t'i drejtohem me një shkresë Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, që t'na ofrojnë informata se çka kanë ndërmarrë ata lidhur me këtë çështje, dhe pastaj nëse është e nevojshme, i informojmë qytetarët e asaj zone.

Kryetarja – Tha se pajtohet që me një përfundim t'i drejtohet Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, për sqarim se çka kanë ndërmarrë lidhur me këtë petition, pasi që qenkan të njoftuar me problemin dhe ka mungesë të njohurive nga ana e qytetarëve për këtë çështje.

Komisioni, pas një diskutimi të gjerë dhe konstruktiv lidhur me petitionin e popullatës së Dragashit, unanimisht nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Peticioni i paraqitur nga banorët e zonës së Parkut Kombëtar "Sharri", i plotëson kushtet formalo-juridike, por kjo çështje nuk bie në kompetencën e këtij Komisioni, prandaj kërkon informata nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, pasi që është Komision funksional, se cilat veprime i ka ndërmarrë lidhur me këtë çështje.

Kurtan Kajtazi – Tha se kemi edhe një njoftim nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, që i është dërguar Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për mungesë të gjyqtarëve në Graçanicë dhe me këtë ka konstatuar se janë shkelur të drejtat e njeriut, si dhe kërkohet nga Këshilli Gjyqësor që të ndërmerren masat e nevojshme e të domosdoshme, që pa vonesa të mëtejshme, të dërgohen gjyqtarë në njësinë e Gjykatës Themelore në Graçanicë, në mënyrë që të fillohet me procedimin e padive të qytetarëve.

6. Të ndryshme

Albana Gashi – Bëri pyetje se a do të realizohet vizita e paraparë në burgun e Lipjanit.

Kryetarja – Tha se kjo vizitë do të realizohet në një të ardhme të afërt, por për shkak të një ftese nga ana e UNDP-së, nesër nuk do të shkojmë, sepse unë kam menduar që kemi ftesa të gjithë anëtarët e komisionit, por isha e ftuar vetëm unë, si kryetare e komisionit. Për këtë arsye, e kemi shtyrë vizitën në burgun e Lipjanit.

Albana Gashi – Propozoi që të bëhet edhe një vizitë në Institutin e Shëndetit Mendor në Shtime, sepse KRCT ka dalë me një raport lidhur me kushtet dhe trajtimin e pacientëve që nuk është i mirë. Propozoi që të bëhet një vizitë në atë institut pa paralajmërim.

Kryetarja – Tha se pajtohet me propozimin e bërë nga anëtarja e Komisionit, ndërsa sa i përket datës se kur do të realizohet vizita, do të dakordohemi dhe do t'ju njoftojmë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali